

Sektori i veprave civile të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 91 paragrafi 3 të Ligjit për gjykata ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010), nenit 160 paragrafi 3 të Rregullores gjyqësore (Gazeta zyrtare e RM" nr.71/2007) dhe neni 46 paragrafi 2 të Rregullores së punës të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë, duke shqyrtuar sipas çështjes juridike me interes për sinkronizimin e praktikës gjyqësore, në seancën e Këshillit të mbajtur me datë 25.02.2020, miratoi siç vijon:

## **M E N D I M   J U R I D I K**

**Organ kompetent për pagesën e detyrueshme të paushallit gjyqësor si shpenzim i procedurës është përmbaruesi, kur kërkesa është e parashtuar nga ana e gjykatave drejtuar përmbaruesit, sipas dispozitave të Ligjit për përmbarim.**

### **A r s y e t i m**

Sektori i praktikës gjyqësore pranë Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datë 16.10.2019 solli Konkluzion për shqyrtimin e çështjeve juridike të caktuara nga ana e Shoqatës së avokatëve S&K nga S., për sigurimin e barazimit në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave.

Çështjet juridike rrjedhin nga kërkesa e parashtuar nga ana e Shoqatës së avokatëve S&K, në të cilën sugjerohet për praktikën gjyqësore të jo sinkronizuar respektivisht për procedimin jo të drejtë të gjykatave.

Në fakt në kërkesën e Shoqatës së avokatëve S&K, në të cilën tregojnë për tre raste joligjore të procedimit të gjykatave lidhur me zbatimin e nenit 4 paragrafi 5 në lidhje me paragrafin 3 të Ligjit për Drejtorinë e të hyrave publike, neni 2 të Ligjit për përmbarim neni 5, 10, 30, 31, 33 dhe 34 të Ligjit për gjykata, ngase konstatojnë se gjykatat kanë kompetencë ireale, kur bëhet fjalë për pagesën e shpenzimeve të procedurave gjyqësore.

### **FAKTE:**

I) Gjykata themelore S. me vendimin e saj PPNI-1144/15 nga 28.12.2015 e aprovon kundërshtimin e parashtuar nga ana e debitorit N.N nga Shkupi dhe konstaton se përmbaruesi N.N ka kryer parregullsi, urdhrin për përmbarim l.nr. 581/15 nga 22.10.2015 të përmbaruesit e shfuqizon, me arsyetim se kompetente për të vepruar dhe për të marrë veprimet e pagesës së detyrueshme për ato shpenzime është Drejtoria e të hyrave publike, e jo përmbaruesi.

Në rastin konkret përmbaruesi në bazë të dokumentit përmbarues – Aktgjykimi PRK nr.336/10-S nga 08.04.2010 të Gjykatës themelore S, ka lëshuar urdhër për përmbarimin e

pagesës të shumës prej 1.000,00 denarë në emër të shpenzimeve në procedurën-gjyqësore paushall si borxh kryesor.

**II)** Gjykata themelore T. me vendim PPNI-88/18 nga 24.07.2018, konfirmuar me vendim të Gjykatës së apelit G. GZH.nr. 1116/18 nga 14.11.2018, kundërshtimin e parashtruar nga ana e debitorit N.N nga Shkupi, lidhur me urdhrin për përbarim I.nr.1399 nga 11.06.2018 të përbaruesit N.N, e refuzon si të pabazë, me arsyetim se kompetent për të vepruar dhe për të marrë veprimet për pagesën e detyrueshme për këto shpenzime është përbaruesi, ngase bëhet fjalë për pagesë të kërkesës në para të paushallit gjyqësor në bazë të dokumentit përbarues – aktgjykim, dhe nuk bëhet fjalë për pagesën e dënimit me para, gjobë ose shpenzime të shqiptuara në procedurë për kundërvajtje në favor të Republikës së Maqedonisë, respektivisht nuk flitet për dhënie publike për të cilën organ kompetent është Drejtoria e të hyrave publike.

Në rastin konkret përbaruesi në bazë të dokumentit përbarues-Aktgjykimi PRK nr. 1192/12 nga 19.08.2014 të Gjykatës themelore G, ka lëshuar urdhër për përbarimin e pagesës të shumës prej 1.000,00 denarë në emër të shpenzimeve në procedurën-gjyqësore paushall si borxh kryesor.

**III)** Gjykata themelore S. me PPNI-1224/18 nga 17.12.2018, kundërshtimin e parashtruar nga ana e debitorit N.N nga Shkupi, sa i përket urdhrin për përbarim I.nr. 1439/17 nga 11.12.2017 të përbaruesit N.N, e refuzon si të pabazë, me arsyetim se kompetent për të proceduar dhe për të marrë veprime për pagesën e detyrueshme për këto shpenzime është përbaruesi, ngase bëhet fjalë për pagesë të kërkesës në para të paushallit gjyqësor në bazë të dokumentit përbarues-aktgjykim, e nuk bëhet fjalë për pagesë të gjobës për kundërvajtje, për pagesën e të cilës është kompetente Drejtoria e të hyrave publike.

Në rastin konkret përbaruesi në bazë të dokumentit përbarues-Aktgjykimi PRK nr.2252/15-S nga 30.09.2015 të Gjykatës themelore G. ka lëshuar urdhër për përbarim për pagesën e shumës prej 1.000,00 denarë në emër të paushallit në procedurë – gjyqësore si borxh kryesor.

**IV)** Gjykata themelore Sh. me vendim PPNI-163/17 nga 20.03.2017, konfirmuar me vendim të Gjykatës së apelit G. GZH.nr. 1123/17 nga 31.10.2017, kundërshtimin e parashtruar nga ana e debitorit N.N përmes autorizuesit N.N avokat nga Shkupi, e refuzon si të pabazë, me arsyetim se kompetent për të proceduar dhe për të marrë veprime për pagesën e detyrueshme të këtyre shpenzimeve është përbaruesi, ngase bëhet fjalë për pagesën e kërkesës në para të paushallit gjyqësor në bazë të dokumentit përbarues-aktgjykim, dhe nuk bëhet fjalë për pagesën e gjobës për kundërvajtje, për të cilën pagesë kompetente është Drejtoria e të hyrave publike.

Në rastin konkret përbaruesi në bazë të dokumentit përbarues-Aktgjykimi PRK – s nr. 6990/14 nga 19.10.2015 të Gjykatës themelore Sh. Ka lëshuar urdhër për përbarim

të pagesës të shumës prej 1.000,00 denarë në emër të procedurës -gjyqësore paushall si borxh kryesor.

Në interes të sigurimit për barazinë në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave, Sektori i praktikës gjyqësore pranë Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në datën 10.05.2019 solli Konkluzion, kërkesa e Shoqatës së avokatëve S&K nga S., të dorëzohet në gjykatat e apelit në Republikën e Maqedonisë së Veriut për tu deklaruar me mendim për çështjet e parashtruara juridike dhe praktikën gjyqësore.

Sektori Civil i Gjykatës së apelit G. me Konkluzion të tij, të sjellë me shumicë votash u deklarua se, për pagesën e detyrueshme për shpenzimet e procedurës për kundërvajtje të paushallit gjyqësor organ kompetent për përmbarrim kundër debitorëve është përmbarruesi, sipas kërkesës së parashtruar nga gjykatat drejtuar përmbarruesve.

Sektori Civil i Gjykatës së apelit Sh. me Konkluzion të tij u deklarua lidhur me çështjen e parashtruar juridike se në lëndët e tilla veprohet sipas nenit 2 të Ligjit për përmbarrim ku është e paraparë që pagesën e detyrueshme të paushallit gjyqësor ta kryejë DHP.

Sa i përket çështjes konkrete juridike si e diskutueshme paraqitet pyetja cili organ është kompetent për pagesën e detyrueshme të shpenzimeve në procedurën- paushall gjyqësor dhe a thua gjatë rasteve të këtilla do të zbatohen dispozitat e Ligjit për përmbarrim ose dispozitat e Ligjit për Drejtorinë e të hyrave publike.

## **ZBATIMI I TË DREJTËS MATERIALE**

LIGJI PËR PËRMBARRIM (tekst i pastruar G. zyrtare e RM nr. 50/13.04.2010)

### **Neni 1**

- (1) Me këtë ligj rregullohen dispozitat sipas të cilave përmbarruesit veprojnë për shkak të zbatimit të detyrueshëm të vendimit gjyqësor që thirret në plotësimin e obligimit, nëse me këtë ose ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.
- (2) Dispozitat e këtij ligji zbatohen në bazë të përmbarrimit të detyrueshëm të vendimit të sjellë në procedurë administrative që thirret në plotësimin e obligimit në para, nëse me këtë ose ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.
- (3) Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe me përmbarrimin në anije dhe mjet fluturues.

LIGJI PËR PËRMBARRIM (G. Zyrtare e RM nr.72 /12.04.2016)

- (1) Me këtë ligj rregullohen dispozitat sipas të cilave përmbarruesit veprojnë për shkak të zbatimit të detyrueshëm të vendimit gjyqësor që thirret në plotësimin e obligimit, nëse me këtë ose ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.
- (2) Dispozitat e këtij ligji zbatohen në bazë të përmbarrimit të detyrueshëm të vendimit të sjellë në procedurë administrative që thirret në plotësimin e obligimit në para, nëse me këtë ose ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.
- (3) Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe me përmbarrimin në anije dhe mjet fluturues.

## **Neni 2**

(1) Bazë e përbarimit paraqet dokumenti përbarues.

(2) Përbarimi fillon me kërkesën e kreditorit.

**(3) Përbarimi i dokumentit përbarues mund të zbatohet vetëm te një përbarues**

Neni 12

(1) Dokumente përbaruese janë:

1) vendimi përbarues dhe marrëveshja gjyqësore;

2) vendimi përbarues dhe marrëveshja në procedurën administrative, nëse kanë të bëjnë për përmbushjen e obligimit në para;

3) dokumenti përbarues i noterit,

4) konkluzioni i përbaruesit për konstatimin e shpenzimeve të përbarimit

5) vendimi me të cilin lejohet përbarimi në bazë të dokumentit autentik të sjellë nga noteri dhe

6) dokumenti tjetër i cili si dokument përbarues parashihet me ligj.

Ligji për Drejtorinë e të hyrave publike ("G. Zyrtare e RM" nr. 43/04/03/2014)

## **Neni 4**

---

(4) Drejtoria e të hyrave publike e drejton edhe përbarimin për pagesën e dënimeve në para, respektivisht gjobave dhe shpenzimet e shqiptuara në procedurat kontestimore, për kundërvajtje, penale dhe administrative në favor të Republikës së Maqedonisë. (5) Vendimi me të cilin përcaktohet dënimi në para, respektivisht gjobë dhe shpenzimet e shqiptuara në favor të Republikës së Maqedonisë nga paragrafi 4 të këtij neni, dorëzohet në Drejtorinë e të hyrave publike nga ana e gjykatës ose organit kompetent që e ka sjellë.

Në rastet konkrete, për shkak se bëhet fjalë për pagesën e kërkesës në para të paushallit gjyqësor në bazë të dokumenteve të detyrueshme gjyqësore-aktgjykim, e nuk bëhet fjalë për pagesën e dënimit në para, gjobë ose shpenzime të shqiptuara në procedurë për kundërvajtje në favor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, respektivisht nuk bëhet fjalë për dhënie publike për të cilën organ kompetent është Drejtoria e të hyrave publike, Sektori i veprave civile pranë Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut solli mendimin juridik siç është ekspozuar më lartë.

**GJYKATA SUPREME E  
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT  
SEKTORI I VEPRAVE CIVILE**